



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:254219
Datë: 29.03.2024
Numri i dokumentit: 05524534

C-IV-14-6980

Ankuesi

L B, Prishtinë

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rruga “Dritan Hoxha”, Nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Diellza Hoxha, me 29 mars 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET ankesa si e pabazuar**
- II. VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN005-0033, i datës 03 tetor 2014, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**
- III. Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesen.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 10 nëntor 2014, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, ankesë kundër Vendimit Nr. PRN005-0033, të datës 03 tetor 2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, me të cilin ka kërkuar kompensimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumë prej 2,100.00 Euro, për periudhën kohore të pacaktuar, nga NSH “Qumështorja Konzume” (në likuidim).

Ankuesi pohoi se NSH nuk i ka kryer obligimet ndaj punëtorëve, gjithashtu ankuesi pohoi se vlerësimi i AL-së është i pabazuar dhe jo mirë i analizuar. Po ashtu ankuesi kërkon nga Dhoma e posaçme, që të anuloi vendimin e kontestuar të AL-së dhe të urdhëroi AKP-në që të miratoi ankesën e paditësit. Ankuesi ka pohuar se nga dhjetori i vitit 1991 dhunshëm ishte larguar nga

puna, nga menagjmenti i AL-së i instaluar nga masat e dhunshme, me arsyetimin e dhen se ishte tepriçë teknologjike.

Në mbështetje të ankesës, ankuesi ka dorëzuar: prokurën speciale, vërtetim dëshmi nga sindikata e pavarur e punëtorëve, aktvendimi i NSH-së Qumështorja Konzume-Nr. 11/34, letra e njoftimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës e datës 21, shkurt 2011, si dhe vendimi i AL-së.

Me 09 mars 2023, e paditura parashtroi mbrojtje, në të cilën pohoi se AL-ja ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. E paditura pohoi se kërkesa e ankuesit është e parashkruar në pajtim me nenin 36.2.1 dhe 37.4.1 të Shtojcës së Ligjit 04/L-034 dhe nenin 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar. Po ashtu e paditura pohoi se afati i parashkrimit nuk lejon AL-në dhe Dhomën e Posaçme të analizojë dhe shqyrtojë themelin e rastit. Më tej e paditura pohoi se ankuesi nuk ka arritur të dëshmojë me një provë të besueshme që atijë i është njohur e drejta në kompensim në emër të ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Andaj AKP-ja kërkon nga Dhoma që të vërtetohet vendimi i AL-së, si i drejt dhe i bazuar në ligj.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet vendimi i AL si i drejt dhe i bazuar në ligj.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësas apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dëshon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Ankuesi fillimisht nuk kishte parashtruar prova relevante në procedurën e likuidimit pranë AL-së, për të mbështetur besueshmërinë e kërkesës së tij. Po ashtu, ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante as në kohën e parashtrimit të ankesës në gjykatë kundër vendimit të AL-së, me të cilat do të mund të dëshmonte se ka ofruar shërbime/punë për NSH-në dhe se NSH-ja detyrohet

për kompensimin e ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës. Ankuesi nuk e ka caktuar as periudhën për të cilën kërkon dëmshpërblim. Ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi as lidhur me llogaritjen e pagave të kërkuara, por vetëm ka theksuar shumën e përgjithshme prej 2.100.00 Euro.

Si përfundim, gjykata gjen se në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për ndërprerjen e parakohshme të kontratës së punës, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Ankuesi e ka bërë pagesën e taksës gjyqësore për ankesën e parashtruar, në shumë prej 20.00 Euro.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Diellza Hoxha
Gjyqtare